


- Banka Evropiane e Investimeve (BEI) ka investuar 853 milionë euro në vitin 2021 si pjesë e mbështetjes së "Team Europe" për Ballkanin Perëndimor. Këto fonde mobilizuan pothuajse 3 miliardë euro nga totali i investimeve.
- Duke qenë banka e Bashkimit Evropian për klimën, BEI-ja ka rritur mbështetjen e saj financiare dhe teknike për tranzicionin e gjelbër në Ballkanin Perëndimor.
- Duke investuar rreth 200 milionë euro në sektorin digjital që nga fillimi i pandemisë së COVID-19, Grupi i BEI-së ka ndihmuar Ballkanin Perëndimor të përshtatet me epokën e re digjitale.



Gjatë vitit 2021, BEI-ja vijoi punën për zhvillimin e qëndrueshëm të Ballkanit Perëndimor përmes projekteve që nxisin një mjedis më të pastër, industri më të gjelbër, mundësi punësimit gjithëpërfshirëse dhe rrjete më të mira digjitale, energjetike dhe transporti. Në kuadër të paketës financiare të "Team Europe" për mbështetje për COVID-19, Banka ka dhënë 1.7 miliardë euro që nga viti 2020 për rimëkëmbje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor, duke mundësuar prosperitet afatgjatë për njerëzit në të gjithë rajonin dhe një ekonomi më konkurruese.

Krahas partnerëve në rajon, BEI-ja ndihmoi në hartimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, duke synuar të nxisë integrimin rajonal dhe konvergjencën me Bashkimin Evropian. Ky transformim socio-ekonomik i gjelbër dhe digjital kërkon angazhim nga të gjitha palët, qasje të reja dhe partneritete që kombinojnë njohuritë dhe mbështetjen financiare. BEI-ja iu bashkua me kënaqësi nismave dhe mundësive të bashkëpunimit që do të ndihmojnë rajonin të avancojë agjendën e tij të gjelbër, transportin e qëndrueshëm dhe digjitalizimin.





Transformimi i gjelbër i ballkanit perëndimor

BEI-ja investoi 257 milionë euro në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit në vitin 2021

Si banka e BE-së për klimën, BEI-ja po shtrin projektet e veprimit për klimën dhe qëndrueshmërinë, duke synuar të mobilizojë 1 trilion euro investime në projekte të gjelbra gjatë kësaj dekade. BEI-ja po punon si pjesë e "Team Europe"¹ për të siguruar që rajoni i Ballkanit Perëndimor të mos lihet pas ndërsa bota po kalon drejt një ekonomie të gjelbër, të qëndrueshme, neutrale ndaj karbonit dhe rrethore. Së bashku me partnerët e saj dhe me qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, BEI-ja po ndihmon në zbutjen e problemeve mjedisore të rajonit dhe po nxit përshtatjen e tij ndaj ndryshimeve klimatike. Në të njëjtën kohë, duke financuar tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme dhe më efikase në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, BEI-ja po ndihmon në diversifikimin dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Banka e plotëson financimin e saj me asistencë teknike të personalizuar për të ndihmuar në zhbllokimin e më shumë investimeve publike dhe private në projektet e energjisë së gjelbër dhe të qëndrueshmërisë, me mbështetjen e Komisionit Evropian. Në mënyrë që të ndihmojë në trajtimin e ndotjes mjedisore, BEI-ja po financon një sistem të ri të shpërndarjes së ujit në Tiranë, sistemet e furnizimit me ujë për disa komuna në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë. Banka gjithashtu po financon dhe jep këshilla për projektet e lëvizshmërisë së qëndrueshme në rajon, përkatësisht modernizimin e transportit urban në kantonin e Sarajevës dhe qytetin e Nishit, përmirësimin e rrjetit hekurudhor dhe përmirësimin e lundrimit përgjatë lumenjve Sava dhe Danub.

1. "Team Europe" u ngrit për herë të parë nga Bashkimi Evropian për të mbështetur vendet partnere në luftën kundër pandemisë së COVID-19. Ai kombinon burimet nga Bashkimi Evropian, Shtetet Anëtare të tij dhe institucionet financiare.



Sigurimi i të ardhmes digjitale dhe të zgjuar

Janë zhbllokuar pothuajse 200 milionë euro për modernizimin që prej vitit 2020

Shpejtësia dhe gjithëpërfshirja e aftësive dhe infrastrukturës digjitale do të përcaktojë shpejtësinë e rritjen socio-ekonomike në rajon dhe konkurrueshmërinë ekonomike në tregun global. Për të siguruar që Ballkani Perëndimor të mund të konkurrojë në tregun global, Grupi i BEI-së ka investuar mbi 200 milionë euro në sektorin digjital vetëm gjatë dy viteve të fundit.

"Si pjesë e "Team Europe", BEI-ja shpreh kënaqësinë që të mund të përshejtojë digjitalizimin në Ballkanin Perëndimor, duke ndihmuar rajonin që të përshtatet me epokën e re digjitale. Digjitalizimi është element kyç për punësimin, qëndrueshmërinë afatgjatë dhe rimëkëmbjen më të shpejtë ndaj krizave. Çdo investim në këtë sektor sjell një sërë përfitimesh, duke zhvilluar ekonomitë e lidhura, konkurruese, të bazuara në njohuri, të qëndrueshme, të orientuara nga inovacioni dhe në lulëzim në rajon", tha Zëvendës presidenti i BEI-së, Lilyana Pavlova (përgjegjëse për Ballkanin Perëndimor).

Grupi i BEI-së e kupton rëndësinë e futjes së hershme të aftësive dhe infrastrukturës digjitale. Për këtë qëllim, ajo ka investuar me pajisje digjitale dhe internet të shpejtë për më shumë se 1500 shkolla, duke përmirësuar infrastrukturën e nevojshme për futjen e rrjetit 5G dhe duke përmirësuar rrjetin ekzistues 4G në Serbi. Këto aktivitete do të kontribuojnë në transformimin digjital, rritjen dhe produktivitetin ekonomik të rajonit, mundësi më të mira punësimi për të rinjtë dhe zhvillimin e kapaciteteve novatore dhe veprimeve për ndryshimet klimatike.

Ndihmë për biznesin e vogël që të rimëkëmbet, të përshtatet dhe të transformohet

Në vitin 2021 janë investuar mbi 560 milionë euro në sektorin privat, si pjesë e paketës financiare me vlerë 1.7 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor në kuadër të "Team Europe"

Grupi i BEI-së ka ofruar mbështetje financiare të prekshme dhe të shpejtë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), punëdhënësit kryesorë në çdo vend të rajonit. Vetëm në vitin 2021, Banka zhbllokoi 560 milionë euro për biznese të tilla në Ballkanin Perëndimor për të siguruar vijimin e veprimtarisë së tyre dhe ofrimin e punësimit. Fondet ishin të disponueshme me kushte të favorshme dhe fleksibël përmes paketës financiare të "Team Europe" për rimëkëmbje më të shpejtë socio-ekonomik dhe mund të aksesoheshin nga kompanitë nëpërmjet bankave tregtare dhe kombëtare të zhvillimit.

Mbështetja e BEI-së ndihmoi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rajon të kapërcejnë barrën e pandemisë së COVID 19, e cila i detyroi kompanitë të punojnë me kapacitet të kufizuar, të shtyjnë planet e investimeve apo edhe të braktisin përkohësisht operacionet (mbi një e treta e shoqërive tregtare sipas Anketës së Ndërmarrjeve të kryer nga BEI-ja, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore). Në të njëjtën kohë, pandemia ka krijuar mundësi për disa sektorë që të përshtaten dhe të ndryshojnë modelet e tyre të biznesit, duke i dhënë shtysë në tregjet që ndryshojnë me shpejtësi. Për të katalizuar këtë transformim ekonomik dhe për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të bëhen më digjitale, më efikase ndaj energjisë dhe gjithëpërfshirëse, BEI-ja ka prezantuar instrumente të reja financiare për sektorin privat gjatë dy viteve të fundit. Këto instrumente përfshijnë financime me ndikim social për të inkurajuar kompanitë serbe që të punësojnë të rinj, gra dhe grupe sociale të cënueshme, dhe një kredi për klimën për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme malazeze të rimëkëmben më shpejt dhe të prezantojnë praktika efikase ndaj energjisë.

Arritjet e Grupit të BEI-së në vitin 2021

Financimi i përgjithshëm i Grupit të BEI-së

Projektet e financuara nga Grupi i BEI-së me vlerë

95 miliardë euro

Financimi i projekteve të gjelbra

51%

e të gjitha financimeve të nënshkruara nga Grupi i BEI-së lidhen me veprimet për klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore

Projektet e nënshkruara

nga BEI-ja për Ballkanin Perëndimor me vlerë

853.5 milionë euro

Kjo përfshin

kredi nga BEI-ja me vlerë

834 milionë euro dhe

grante me vlerë

19.5 milionë euro

Projektet e nënshkruara

nga Grupi i BEI-së për Ballkanin Perëndimor që prej vitit 2009 arrijnë afërsisht

9.5 miliardë euro

Numri i vendeve të punës

të ruajtura që prej vitit 2009 falë financimit të BEI-së shkon mbi

900 000

PIKA KONTAKTI PËR SHTYPIN

Gordana Kovačević
+381 60 323 3435
+381 11 3121756
g.kovacevic@ext.eib.org

Përfaqësia Rajonale për
Ballkanin Perëndimor
Vladimira Popovića 38
Beograd
Serbi
+381 11 3121756
belgrade@eib.org

Zyra e Shtypit
+352 4379-21000
+352 4379-61000
press@eib.org
www.eib.org/press

PIKA TË PËRGJITHSHME KONTAKTI

Banka Evropiane e Investimeve
98-100 boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luxembourg

Këndi i Informacionit
+352 4379-22000
+352 4379-62000
info@eib.org – www.eib.org